VENDIM
Nr.1132, datë 5.8.2008

PËR MIRATIMIN E NORMAVE PËR GRUMBULLIMIN E QUMËSHTIT TË PAPËRPUNUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9441, datë 11.11.2005 "Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e normave për grumbullimin e qumështit të papërpunuar, nga ferma prodhuese në qendrat grumbulluese ose përpunuese, në çastin e dorëzimit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Zbatimi i normave të përcaktuara në shkronjat "a", "b" e "c" të lidhjes së përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, të kontrollohet, në mënyrë të vazhdueshme ose me sondazhe si në fermë, edhe në qendrën e grumbullimit apo në qendrën e përpunimit.

3. Për të parë nëse janë përmbushur normat e miratuara me këtë vendim të kryhen teste të veçanta, në mënyrë të vazhdueshme ose periodike, të mostrave përfaqësuese, marrë prej qumështit të papërpunuar, të prodhuar në çdo fermë. Testet të kryhen nga organet përgjegjëse të kontrollit, të përcaktuara në kreun VIII të nenit 24 të ligjit nr.9441, datë 11.11.2005 "Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi".

Mënyra e matjes së treguesve dhe e llogaritjes së mesatares gjeometrike të përcaktohen me rregullore të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

NORMAT PËR GRUMBULLIMIN E QUMËSHTIT TË PAPËRPUNUAR NGA FERMA PRODHUESE NË MOMENTIN E DORËZIMIT NË QENDRAT GRUMBULLUESE OSE PËRPUNUESE

a) Për qumështin e papërpunuar të lopës

Qumështi i papërpunuar (lëndë e parë) i lopës, që pas procesit të trajtimit termik do të përdoret për prodhimin e qumështit të konsumit, si dhe për qumështra të fermentuar, kos, qumështra të xhelatinuar ose aromatizuar, kremëra qumështi, djathra dhe produkte të tjera me bazë qumështi, duhet të plotësojë normat e mëposhtme:

Treguesit	Faza I Deri më 31.12.2009	Faza II Deri më 31.12.2011	Faza III Deri më 31. 12.2013
Përmbajtja e mikroflorës së përgjithshme (mezofile aerobike) në 30°C (për ml)	<2 500 000 (a1)	<1 000 000 (a2)	≤100. 000 (a3)
Përmbajtja e qelizave somatike (për ml).	<700 000 (b1)	<500 000 (b2)	≤ 400. 000 (b3)

ku:

- al, a2, a3 është mesatarja gjeometrike, llogaritur për një periudhë prej 2 muajsh, me të paktën 2 prova në muaj.

- b1, b2, b3 është mesatarja gjeometrike, llogaritur për një periudhë prej 3 muajsh, me të paktën 3 prova në muaj.

b) për qumështin e papërpunuar të deles e dhisë.

Qumështi i papërpunuar i delës dhe i dhisë (lëndë e parë) që pas procesit të trajtimit termik do të përdoret për prodhimin e qumështit të konsumit, si dhe produkte të tjera me bazë qumështi, duhet të plotësojë normat e mëposhtme:

Treguesit	Faza I Deri më 31.12.2009	Faza II Deri më 31.12.2011	Faza III Deri më 31.12.2013
Përmbajtja e mikroflorës së përgjithshme (mezofile aerobike) në 30°C (për ml)	<8 000 000 (a1)	<3 000 000 (a2)	≤1 500 000 (a3)

ku:

- al, a2, a3 është mesatarja gjeometrike, llogaritur për një periudhë prej 2 muajsh, me të paktën 2 prova në muaj.

c) Për qumështin e papërpunuar të buallicës.

Qumështi i papërpunuar (lëndë e parë) i buallicës që do të përdoret për prodhimin e produkteve me bazë qumështi duhet të plotësojë normat e mëposhtme:

Treguesit	Normat
Përmbajtja e mikroflorës së përgjithshme (mezofile aerobike) në 30°C (për ml)	≤ 1 000 000 (a)
Përmbajtja e qelizave somatike (për ml)	≤ 500 000 (b)

ku:

a - mesatarja gjeometrike e llogaritur për një periudhë prej 2 muajsh me të paktën 2 prova në muaj.

b - mesatarja gjeometrike e llogaritur për një periudhë prej 3 muajsh me të paktën 1 provë në muaj.